



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Relacion mbi zbatimin e buxhetit për periudhën Janar-Prill 2021

Në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore” dhe Rregullores së Kuvendit, me mbylljen e periudhës 4 mujore, Shërbimi i Financës dhe Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtuesit e Ekipeve të Programeve buxhetore, kanë analizuar treguesit financiarë faktikë, duke përcjellë këtë informacion.

Monitorimi i treguesve buxhetore në mënyrë krahasimore plan fakt dhe në lidhje me performancën e kësaj periudhe ka për qëllim të ndjekë arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, të evidentojë realizimin e produkteve sipas planit, të ndërmarrë veprime korigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve, të sigurojë informacion i cili do të shërbejë për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.

Buxheti i vitit 2021 është miratuar me ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe synon të mbështesë të dy programet buxhetore, në arritjen e qëllimit të politikave përkatëse.


Tabela nr.1 paraqet buxhetin vjetor sipas ligjit, planin 4 mujor sipas detajimit dhe realizimin faktik janar-prill 2021:

Emërtimi	plan vjetor sipas ligjit	Plan 4 mujor	Fakti 4 mujor	% realizimit planit 4 mujor
a	1	2	3	4=3/2
Shpenzime për paga	546.320.000	182.106.000	150.015.000	82.38 %
Shpenzime për sigurime shoqërore	81.000.000	27.000.000	22.665.000	83.94 %
Shpenzime për blerje mallra dhe shërbime	392.750.000	119.450.000	79.555.000	66.60 %
Kuota parlamentare	15.090.000	15.040.000	14.956.000	99.44 %
Shpenzime kapitale (investime)	118.000.000	27.733.000	4.920.000	17.74 %
T O T A L I	1.153.160.000	371.329.000	272.111.000	73.28 %


Ndërsa totali i buxhetit vjetor të Kuvendit është realizuar 23.59 % në periudhën katërmujore, ndaj planit 4 mujor realizimi është 73.28 %.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, realizimi është më i lartë, duke sjellë në vëmendje që vitin e kaluar, u përballëm me pandeminë që në fillimet e muajit mars dhe u pezulluan aktivitetet (përfshirë dhe prokurimet).

Grafikisht realizimi plan-fakt 4 mujor paraqitet (në mln lekë):



Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar :




Numri i punonjësve

Ligji “Për buxhetin e vitit 2021” ka miratuar për Kuvendin numrin 409 të punonjësve (staf politik përfshirë deputetët si dhe stafin administrativ) dhe me vendim të Këshillit të Ministrave janë miratuar 12 punonjës me kontratë të përkohshme.

Fondi faktik 4 mujor i pagave dhe sigurimeve shoqërore është shpenzuar për një numër 340 punonjës dhe deputetë, si dhe 9 punonjës me kontratë.

Numri i punonjesve plan fakt per 4 mujorin e parë 2021 paraqitet grafikisht:



Shpenzimet për paga dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore

Plani 4 mujor i këtyre shpenzimeve është realizuar në masën 82.58 %.

Shpenzimet për paga në programin legjislativ planifikohen për një numër prej 140 deputetësh, ndërsa numri faktik në katërmujor është 108, për shkak të veçorive që pati kjo legjislaturë (kjo do të ndryshojë me fillimin e legjislaturës së re).

Siç shihet nga grafiku, edhe numri i punonjësve të stafit politik dhe administrativ nuk është i rekrutuar plotësisht.

Punonjësit me kontratë gjithashtu do të plotësohen për periudhën në vazhdim, pasi inventarizuesit janë planifikuar të rekrutohen në 6 mujorin e dytë të vitit.

Shpenzimet operative për blerje mallra e shërbime

Ky grup shpenzimesh si katërmujor është realizuar në masën 66.6% e planit katërmujor.


Një peshë specifike të konsiderueshme në këtë zë paraqesin shpenzimet për mirëmbajtje të sistemeve elektronike, të cilat bazohen në kontrata më shumë se një vjeçare dhe ndiqen nga grupe pune të përcaktuara zyrtarisht. Vlera e realizimit në 4 mujor është 15,2 milion lekë.

Në Kuvendin e Shqipërisë janë funksionale sistemi elektronik i votimit, sistemi Audio Video në ambjentet ku zhvillohen mbledhjet e komisioneve të përhershme, në ambjentet e sallës së mbledhjeve të grupeve parlamentare, sistemi e-parlament, sistemi i menaxhimit të dokumentacionit DMS, rrjeti wireless, faqja zyrtare, aplikacionet për monitorimin e institucioneve të pavarura, aplikacioni Kuvendi i Shqipërisë etj.

Përfitimet financiare ligjore të deputetëve zënë gjithashtu një peshë të konsiderueshme.

Sipas vendimit të Byrosë së Kuvendit numër 74 datë 25.02.2021, deputetët, për periudhën e fushatës zgjedhore 25 mars - 25 prill 2021, nuk kanë përfiturat dieta, karburant apo qera banese, pasi nuk ka patur aktivitet parlamentar.

Grupet kryesore të këtij zëri të paraqitura grafikisht (në milion lekë) dhe të krahasuara me të njëjten periudhë të vitit të kaluar paraqiten grafikisht si më poshtë:



Shpenzimet për kuotat parlamentare

Gjatë periudhës janar-prill 2021 janë paguar detyrimet vjetore për kuotat parlamentare në ato organizata ku bën pjesë dhe Kuvendi i Shqipërisë si OSBE, IPU, NATO, PABSEC, PAM. Realizimi 4 mujor paraqitet 99.44%

Fondi i veçantë

Me udhëzimin plotësues nr.4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përcjellë dhe tabelën e shpërndarjes së fondit të veçantë në Institucione. Për Kuvendin është përcaktuar vlera 1 milion lekë.

Ky fond është akorduar i gjithi në Kuvend, dhe është përdorur në përputhje me kriteret e përcaktuara në vkm nr.929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar (përdorimi në rastet për fatkeqësi në familje ose për dalje në pension).

Për katërmujorin e parë të vitit 2021 janë përdorur 316 mijë lek, për raste fatkeqësie në familje dhe dalje në pension.

Investime Kapitale

Në vitin buxhetor 2021, Kuvendit i janë akorduar fonde nga buxheti i shtetit në vlerë 118 milion lekë, të cilat janë detajuar në projekte si në tabelë:

Tabela e projekteve të investimeve për vitin 2021

në milion lekë

Emërtimi i projektit	Plani	Ndryshimet	fakti 4 mujor	% e realizimit ose komente sqaruese
Sistem i infrastrukturës virtuale (VDI)	31	0	4,9	15,8 % (vlera e realizimit faktik i perket kontratës së vitit 2020, ndërsa për vitin 2021, po ndiqen procedurat e prokurimit (ka përfunduar vlerësimi nga komisioni perkates)

Ndërtimi faqes së re zyrtare	2,5	0	0	Në proces prokurimi
Bashkëfinancim për qendrën e vizitorëve	7	0	0	Është nënshkruar marrëveshja
Blerje pajisje zyre	54	+32,632	0	0,00%
Studim projektim për sistemin qendror të ventilimit dhe kondicionimit	0	+0,736	0	Projekti është realizuar nga Instituti i ndërtimit dhe po i bëhet oponenta
Sistemi Business Continuity center (BCC)	26,520	-26,520	0	Nuk do realizohet në vitin 2021
Rikonstruksion i rrjetit elektrik	29,342	-29,302	0	Është realizuar oponenta dhe po vlerësohet dhe nga Instituti i ndërtimit
Blerje libra	0,2	0	0	Në proces prokurimi
Rikonstruksion punime hidroizolim tarrace	0	+22,454	0	Është në process prokurimi, ndërsa i është realizuar projekti nga IKTK dhe oponenta nga Instituti i ndërtimit.
Totali	118	0	4,9	0.04 %

Ndryshimet në projektet e investimeve janë kërkuar nga Kuvendi dhe janë miratuar nga Ministria e Financave me shkresën nr.5602/2 datë 22.04.2021.

Realizimi 4 mujor i investimeve paraqitet i ulët, për shkak se kjo periudhë i përket periudhës së kryerjes së specifikimeve teknike, llogaritjes së fondit limit dhe fillimit të procedurave të prokurimi si dhe të tjera shpjegime që dhënë në kolonën e komenteve, në pasqyrë mësipërme.

